

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



e-buletini
no.10
Janar-
Qershor 2015

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë

.....
"Kosta Veselinov" 3a,
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
.....

www.ruralnet.mk





Në këtë numër...



- | | |
|---------------|---|
| 1
faqe 3 | Zbatohen aktivitete të Shoqatës së Artistëve Artizanë “ARTI KRAFT” |
| 2
faqe 5 | Zhvillimi rural – turizmi i qëndrueshëm |
| 3
faqe 6 | Projekti ORGANIKA |
| 4
faqe 7 | Aktivitete dhe arritje të Art Point – Gumno |
| 5
faqe 9 | Promovimi i Qendrës Vullnetare për Resurse në Gjevgjeli |
| 6
faqe 10 | Aktivitete të SHME “Zakamen” Strugë – projekti “Të rinjtë në lëvizje” |
| 7
faqe 11 | “Cvet” nga Krusheva – promotor aktiv i traditës dhe kulturës krushevare |
| 8
faqe 12 | Shënohet dita e parë e pranverës në Pehçevë |
| 9
faqe 13 | Fëmijë kultivojnë shalqi dhe fasule në manastirin “Virgjëresha e Shenjtë” në Matkë |
| 10
faqe 14 | Kuvendi vjetor i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë |
| 11
faqe 15 | Rrjeti për Zhvillim Rural, pjesëmarrës në Programin e USAID për Përmirësimin e Punës së Organizatave (PPPO) |
| 12
faqe 17 | Koncepti i mekanizimit për projekte |
| 13
faqe 18 | Afirmim të LEADER qasjes në Rajonin Juglindor dhe Lindor të Planifikimit |
| 14
faqe 19 | Prezantim të zbulimeve të Studimit për Adaptimin e Prodhimtarisë Bagëtores në Republikën e Maqedonisë ndaj ndryshimeve klimatike në Manastir |
| 15
faqe 20 | Zhvillohet seanca e shtatë kuvendare e RBZR |
| 16
faqe 21 | Parlamenti i Dytë Rural në Letoni dhe takimi i PREPARE Partneritetit për Evropë Rurale |



1

Zbatohen aktivitete të Shoqatës së Artistëve Artizanë “ARTI KRAFT”



Nevojat e krijimit të sistemit të organizuar për ruajtje, kujdes dhe promovim të vlerave kombëtare dhe artizaneve që po zhduken në vendin tonë, por edhe më gjerë në Ballkan, është gjithnjë më evidente.

Në këtë frymë, një grup me entuziazëm kanë themeluar shoqatën e artistëve dhe artizanëve “ARTI KRAFT” që ka për qëllim të promovimit dhe përdorimit të vlerave dhe zakoneve kombëtare dhe kulturore me anë të bashkimit të kombësive që krijojnë dhe zhvillojnë në Maqedoni. Në vitin 2015, shoqata u bë anëtare e Rrjetit për Zhvillim Rural të RM-së.

Në kuadër të qëllimeve programore dhe projektit, shoqata, për periudhë prej 6 muajve ka zhvilluar një numër të aktiviteteve:

1. Me rastin e 8 marsit “Dita e Gruas” në h. Kontinental – Shkup, ka zhvil-

luar një Pazar të veprave kreative artistike. Produktet e ekspozuar kanë shfaqur art, cilësi dhe mprehe tek punimet. Ata me duart e tyre të vyeshme dhe vlefshme e lidhin traditën e kulturën e jetës me kohën bashkëkohore dhe krijojnë produkte që të ndalin frymën dhe janë festë për sytë dhe shpirtrat që i stolisin shumë gra.

2. Me rastin e festës fetare pashkë në hotel kontinental me produkte të mrekullueshme kushtuar ditës, u prezantuar më tepër se 20 artistëve.
3. Projekti i hartuar me titullin e punës “Kolazhi Artizanal 2015”, në sajë të projekteve nga fusha artizanale e Qytetit të Shkupit për vitin 2015 ishte zbatuar nga ana e SHAP “ARTI KRAFT” dhe qytetit të Shkupit. Pazari veror i punimeve vendore ishte organizuar më 21 dhe 22 maj 2015, në shtetin Filipi





i Dytë në Shkup. Me anë të këtij manifestimi atraktiv janë prezantuar punuesit, artistë dhe artizanët që punojnë artizane të vjetra si dhe talente të reja që me anë të krijimeve të tyre e prezantojnë artin maqedonas dhe kulturën në një vend. Një gëzim i madh tek të gjithë ishte që PAZARI u zhvilluar gjatë festës ortodokse krishtere SPASOVDEN dhe Shën Nikolla. Me zbatimin e aktiviteteve të projektit ishin vendosur kontakte fillestare dhe mundësi për zbatimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes përfaqësuesve të LAG dhe Qytetit të Shkupit dhe SHAP ARTI KRAFT nga Shkupi.

4. Historinë e grumbullimit të punimeve nga Ballkani në Shkup, që e kemi filluar që nga viti 2013, e plotësojmë më vitin e tretë me radhë në organizim dhe ndihmë të kryetarit të Komunës së Çairit, z-Izet Mexhiti. Në sheshin Skenderbeg në çarshinë e vjetër të Shkupit më 15 dhe 16 qershor 2015 u zhvillua PAZARI BALLKANIK i punimeve vendore me titullin "ditët e kulturës dhe artizaneve të Ballkanit në Shkup". Ishin prezantuar artistë, artizanë nga Turqia, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, BH dhe mysafirë nga Gjermania që me artet e tyre e pasuruar këtë ngjarje që për ne është me rëndësi të madhe, ndërsa ne nikoqirët nga më


shumë qytete të Maqedonisë (Kumanovë, Kavadar, Pal-lankë, Veles, Shtip, Manastir dhe Shkup), me krenari vazhdojmë me këtë vepër.

5. Me rastin e Ditës së Sipërmarrjes për Gra nga 14-16 maj 2015, në Sarajevë, në ftesë të Organizatës së Sipërmarrjeve SNAGA ZHENA bashkë me Shoqatën e Grave në Biznes të RM-së ku SHAP ARTI KRAFT – Shkup është anëtare kolektive, kanë marrë pjesë aktive në panairin dhe në konferencën me titull "Çfarë sjell LIGJI i ri për punë për gratë nga rajoni", kryetari dhe nënkryetari i SHAP ARTI KRAFT – Shkup.
6. Prej 19 deri 27 qershor 2015 katër anëtare të ARTI KRAFT kanë marrë pjesë në trajnim për përpunim të punimeve me filc teknikë në Shkup në organizim në OJQ Turke dhe trajnues nga KOCAELI/Turqi.

Pjesëmarrjet në Maqedoni gjatë periudhës verore planifikohen në Pehçevë, Manastir, Ulqinj dhe Turqi.

Ideja e anëtarëve të SHAP ARTI KRAFT është që gjërat dhe veprat e tyre unike të ekspozojnë në një hapësirë galerie të hapur që do të merrnin falas nga shteti, sepse veprat e tyre janë shënime, dëshmitarë të së kaluarës për popullin, rrëfejnë një kulturë të pasur të gjithë popujve në këto vise që janë mbijetuar me shekuj të tërë.

Tekstin ka përgatitur Mitrovska Gordana Beba Përfaqësues i autorizuar i SHAP ARTI KRAFT Shkup/Maqedoni





Zhvillimi rural – turizmi i qëndrueshëm



Inciativa e projektit “Turizmi rural zhvillim i qëndrueshëm”, e mbështetur nga projekti i USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, ishte inkurajuar dhe zbatuar nga Shoqata e prodhuesve të llojeve kopshtare dhe luleve HORTI EKO dhe Shoqatës së fermerëve gra AGRO-Vinka Vinicë, dy anëtare të Rrjetit për Zhvillim Rural.

Ishin organizuar 2 trajnime në temën “Turizmi rural zhvillim i qëndrueshëm”



nga që njëra ishte organizuar më 4 dhe 5 qershor 2015 në restorantin Panorama Mokrino në f. Mokrino ndërsa tjetra më 17 dhe 18 qershor 2015 në Vinicë, në fshatin Istibanja dhe fshatin Bllatec. Në trajnimet kishte pjesëmarrës nga rajoni i Vinicës dhe Strumicës, që kanë pasur mundësinë të përfitojnë më tepër njohuri nga fusha e turizmit rural dhe të njoftojnë rajonin me anë të vizitave në teren që ishin organizuar tek Burimet e Mokrines, lokalit e familjes Tançevi, ujëvarat e Koleshinës, tremat romake në Banja Bansko dhe fushën e Strumicës si dhe në rrethinën e Vinicës – fshatin Istibanja. Ishin vizituar më tepër vende që do të mund të kontribuojnë për zhvillimin e turizmit rural në rajonin si fermë peshqish tek një fermer në Llaki, etno restorantin Konak, punëtorinë e gdhendjes së drurit, manastire, kisha, çezma të fshatit, etj.





Projekti ORGANIKA



Shoqata Instituti për Zhvillimin e Bashkësisë (IZB) – Tetovë, në kuadër të aktiviteteve të programi, punon në realizimin e projektit “Organika”.

Projekti është pjesë e aktiviteteve të RZR për mbështetjen e iniciativave të projektit të organizatave anëtare. Projekti është me kohëzgjatje prej dy muajve. Partner i projektit është Shoqata e Fermerëve Gra Moja Farma - Gostivar.

Qëllimi i projektit është rritja e interesit të fermerëve për prodhimtari të ushqimit organik, përvetësimin e njohurive, shkathtësive të qytetarëve për prodhimtari më cilësore të ushqimit organik me anë të konsultimeve, këshillimeve, informimit, edukim të qytetarëve. Aktivitetet në kuadër të projektit do të përmirësojnë punën e tyre me çfarë do të ndikohet mbi të ardhurat e familjeve dhe do të kontribuojë për zhvillimin rural.

IZB punon në zbatimin e projektit dhe janë realizuar disa aktivitete të projektit:

- Faza përgatitore, takim pune me fermerët që është zhvilluar në fshatin Jançisht. Ishte takim konsultimi me qytetarët e interesuar, njohje të fermerëve, vendosja e kanaleve të komunikimit.
- Punëtori me fermerët, në të cilën fermerët i kanë zgjeruar njohuritë e tyre për prodhimtarinë organike, dhe bashkimit në kooperativë. Janë vendosur drejtimit e bashkëpunimit dhe strategjia zhvillimore.

Për momentin punohet në krijimin e ueb faqes që do të promovohet në konferencën përfundimtare, në kuadër të së cilës do të mbahen edhe dy punëtori në fushën e prodhimtarisë organike, prezantim të produktive dhe panel diskutim në tema relevante.

Me zbatimin e aktiviteteve të parashikuara, do të përforcohen kapacitetet e fermerëve që do të përfitojnë njohuri të reja, shkathtësi dhe do të nxitet bashkimi i tyre për realizimin e rendimenteve më të mëdha dhe cilësi të produkteve.

Për më tepër informacione, vizitoni internet faqen në www.irz.org.mk



Aktivitete dhe arritje të Art Point – Gumno

1. Ekspozita në rrugë: “BIMËT E EGRA TË RRETHINËS SIME”

1.1. “Art Point – Gumno” ka filluar vitin me vazhdimin e ekspozitës në rrugë me titull “BIMËT E EGRA TË RRETHINËS SIME”. Bëhet fjalë për shfaqje origjinale të vizatimeve, herbariume dhe fotografi të hartuar nga vullnetarë të gjithë të bashkuar në projektin: “Lidhja e njerëzve me natyrën – përforcimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni”. Ky projekt ishte realizuar në bashkëpunim me Plantlife International, nga Britani e Madhe dhe Shoqatës Maqedonase Ekologjike nga Shkupi. Pika e fundit e ekspozitës që ka udhëtuar nëpër Demir Hisar, Manastir, Ohër dhe Tearcë ishte EU Info Qendra në Shkup ku në mënyrë simbolike, me mbylljen e ekspozitës më 31 maj ishte shënuar edhe fundi i projektit (21.03. – 31.05.2015).

1.2. Ngjarja “Shartimi i llojeve autoktone të frutave” ishte organizuar në kuadër të projektit të njëjtë. Bashkë me përfaqësues të CSU “Krste Petkov Misirkov” nga Demir Hisari, ishin mysafir të ED GRASHNICA nga Ohri, në f. Zavoje ku nikoqirë ishin shartuesit e njohur – xhaxhi Kerste dhe Naumçe që me vite i mbjellin shtrusat e egra me lloje autoktone të mollës dhe dardhës që kanë origjinën që prej periudhës turke. Shoqata Maqedonase Ekologjike – MED ka siguruar ndihmë profesionale nga ana e prof. Dr. Tosho Arsov, cili me tjerave ka dhënë një theks të veçantë në pjesën e mbrojtjes së biodiversitetit. (17.04.2015)

2. Fillimi zyrtar i projektit: “PËRSHËNDETNI ZOGJTË NGA MALI ILIN-PLLAKEN!”

Më 18 prill, zyrtarisht kanë filluar aktivitetet në teren nga projekti i mbështetur nga Shoqata Maqedonase Ekologjike – MED dhe Euronatur nga Gjermania. Qëllimi kryesor i projektit është promovimi i biodiversitetit me anë të identifikimit dhe njohës së zogjve dhe vendbanimet e tyre në rajonin e malit Ilin-Plлакën dhe pjesës Bellçansko Bllato (komuna e Dmir Hisarit). Me projektin do të rrite vetëdija publike e popullatës lokale dhe turistëve për zogjtë dhe rëndësia e tyre për natyrën në rajon. Njëherë, me këtë projekt do të mbështeten aktivitetet për monitorin të zogjve në MK dhe procesit të vendosjes së rajonit NATURA 2000.



Akt 1_1_TravelingExhibition_EU Info Center
– punëtori kreative me fëmijët e kopshtit SPIRIT në hapjen e ekspozitës në rrugë në EU Info Qendrën në Shkup (18.05.2015)



Akt 1_2_Crafting autohtonic varieties_2
– Prof. Dr. Tosho Arsov gjatë demonstrimit praktik të shartimit



Akt 2_How do we recognize birds_MED Expert – Eksperti i MED, Ksenija Putilin gjatë prezantimit të njohjes dhe monitorimit të llojeve përkatëse të zogjve në Slloeshticë



Në projektin në mënyrë aktive marrin pjesë 10 vullnetarë nga f. Slloeshticë, f. Zhvan dhe f. Virovë, dhe përveç mbështetjes profesionale të ekspertëve nga Shoqata Maqedonase Ekologjike – MED (monitorim të zogjve), kontributin e tyre kanë dhënë edhe artistë, mysafirë të rezidencës artistike e APG (punëtori kreative me vullnetarët).

3. Rezidenca artistike “Art Point – Gumno” 2015

Për herën e 14 me rend, Rezidenca Ndërkombëtare Artistike u zhvillua prej 11 qershor deri më 6 korrik të këtij viti. Edhe këtë herë, punësoria mbushi kriteret e mëdha të organizatorëve – kanë marrë pjesë katër artistë të njohur të botës me vulën origjinale të autorëve: Mishel Konoli nga Australia, Beti Bricelj nga Sllovenia, Joshkin Shiljan nga Serbia dhe Leon Paçet nga Mbretëria e Bashkuar (Skoci). Dashamirët e artit kanë pasur mundësi drejtë të takohen me artistët dhe të shohin veprat e tyre gjatë ngjarjes “Studio e Hapur” që këtë vit u mbajt më 21 qershor.

Projekti u realizua me mbështetjen e pjesshme të Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë.

Më tepër informacione për shoqatën Art Point – Gumno do të gjeni në ueb faqen e tyre: www.artpoint-gumno.org.mk



Akt 2_Monitoring of the birds – Grup i vullnetarëve bashkë me artistë dhe ekspertët në monitorim në teren të zogjve në rajonin e f. Slloeshticë



Akt 2_Minutes from Creative WS - Artisti nga Serbia fqinje, Joshkin Shiljan dhe pjesë e vullnetarëve gjatë punëtorisë kreative



Akt 3_Leon Patchett_Work in progress – Leon Paçet nga Britania e Madhe krijon skulpturën me boçe pishe



Akt 3_Beti Bricelj_New work coming – Beti Bricelj nga Sllovenia, në punë në studion e APG



Akt 3_Poseta na APG_Otvoreno studio – pjesë e atmosferës në vetë fillimin e ngjarjes Studio e Hapur



Akt 3_Michelle Connolly and others_working outside – Pjesë e atmosferës së punës në APG, Mishel Konoli nga Australia dhe artistët tjerë



5

Promovimi i Qendrës Vullnetare për Resurse në Gjevgjeli



Aktivitetet e deritanishme dhe të ardhshme të Qendrës Vullnetare për Resurse – Gjevgjeli ishin prezantuar në promovimin e Qendrës Vullnetare për Resurse – Gjevgjeli që ishte zhvilluar më 11 maj 2015 në hotel Apolonia.

Në ngjarjen përfaqësuesit e kompanive, organizatave dhe institucioneve nga komuna e Gjevgjeli kanë pasur mundësinë të informohen dhe të diskutojnë për përfitimet që mund të kanë me përfshirjen e tyre si përdorues të shërbimeve që ofrohen nga Qendrës Vullnetare për Resurse (QVR).

Promovimin ka hapur dhe zhvilluar Magdalena Stamkova, kryetare e Shoqatës për Edukim të Fëmijëve dhe të Rinjve “Sllozhuvllka”, organizatë partner-realizues i projektit, e cila i njoftoi të pranishmit me idenë e QVR-së, si program që promovon vullnetarizëm dhe përgjegjësi shoqërore në mesin e të rinjve. Pastaj, Risto Atanasovski, menaxheri i FLORIT, organizatë që është mbështetëse aktive e realizimit të QVR-së me anë të sigurimit të resurseve dhe shkëmbimit të përvojave, ka theksuar nevojën për bashkëpunim të ndërsjellë dhe promovim të OJQ-ve lokale. Në ngjarjen, përvojën ka ndarë edhe Aco Ristovski, drejtor i Fonda-

cionit Apollonija, organizatë-iniciator për hapjen e QVR-së, i cili në pika të shkurta tregoi zanafillat e krijimit të këndit lokal për vullnetarë.

Qendra Vullnetare për Resurse është hapur në vitin 2014 nga ana e Fondacionit Apolonia dhe SHEFRSL-Oozhuvallka, si përgjigje e njëjës së identifikuar në tregun e punës dhe kualifikimet e punës për të rinjtë dhe shkathtësitë e nevojshme të sektori lokal privat.

Në gjysmën e dytë të gushtit 2015 do të fillojë të zbatohet edhe cikli i dytë i aktiviteteve të QVR-së, në të cilën janë parashikuar të zhvillohen trajnime dhe seminare për hartimin e CV-së, letër motivimi dhe këshilla për sjellje të drejtë gjatë intervistës, folje publike, bazat e punës administrative, punësim online, IT shkathtësi të dobishme, marketing-promovim me anë të rrjeteve sociale dhe menaxhim me projekte.

Qendra Vullnetare për Resurse është formuar me anë të punës vullnetare për të krijuar kushte për kuadro të kualifikuar të punës që me sukses do të përgjigjet nevojave të sektorit lokal privat në komunën e Gjevgjeli.

Qëllimi kryesor i QVR-së është të zhvillojë kapacitetet e të rinjve me anë të një serie të punëtorive për shkathtësi të

buta dhe promovim praktik të vullnetarizmit dhe të mundësojë përfitimin e shkathtësive, që do të bëjnë kandidatë më konkurrent në tregun e punës, duke përmirësuar procesin e adaptimit ndaj pozitave të ardhshme të punës/praktikës.

Ngjarja është organizuar nga Shoqata për Edukimin e Fëmijëve dhe të Rinjve SLOZHUVALLKA, Gjevgjeli në partneritet me FLORIT dhe Fondacionin Apolonia, ndërsa mbështetet nga Rrjeti për Zhvillim Rural dhe Detra Qendra në kuadër të projektit të USAID.

Përveç përgatitjes për ciklin e ri të trajnimeve dhe seminareve të QVR-së, SHEFR Sllozhuvallka me shpejtësi përgatitet për pjesëmarrje në pjesën “Zonë për aksion qytetar” në D-Festivalin në Dojran prej 17-19 korrik 2015, ku shoqata do të ofrojë agjendë dy ditore në të cilën do të organizohen disa punëtori dhe një sërë lojërash shoqërore për vizitorët, për të promovuar qëllimet dhe aktivitetet si dhe trajnimet në QVR.

Gjithashtu, SHEFR Sllozhuvallka këtë vit ka mbështetur iniciativën për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për të Rinj 2015 në Gjevgjeli, ku për herë të dytë do të organizohet një ngjarje një ditore me të cilën do të promovohet kapaciteti i të rinjve për kyçe në shoqëri me anë të shqyrtimit të temave e interes të përbashkët dhe promovim të talenteve lokale të reja. Ngjarja do të zhvillohet më 12 gusht 2015, ndërsa paraprakisht, në bashkëpunim me përfaqësues dhe vullnetarë nga Fondacioni Apolonia dhe Qendra për Mbështetje të OJQ-ve do të organizohen aktivitete për mbledhjen e mjeteve për realizimin e ngjarjes.

Për gjitha informacionet lidhur me QVR-Gjevgjeli dhe aktivitetet e tjera të SHEFR Sllozhuvallka, na kontaktoni në info@slozuvalka.org.mk



6

Aktivitetete të SHME “Zakamen” Strugë – projekti “Të rinjtë në lëvizje”



Nga muaji prill deri qershor 2015 shoqata malore ekologjike “Zakamen” nga Struga ka realizuar projektin “Të rinjtë në lëvizje”. Qëllimi i projektit ishte ngritja e vetëdijes dhe edukimit të popullatës lokale për llojlojshmërinë biologjike të malit Jablanicë, me qëllim të ruajtjes së tyre dhe përdorimit të drejtë në kohën që vije. Grupi synues i projektit ka përfshirë të rinjtë nga mosha 14-26 vjeç.

Si pjesë e projektit, ishin realizuar 4 aktivitetete:

1. Ligjërata edukative në shkollat e mesme “Niko Nestor” dhe “Dr. Ibrahim Temo” në Strugë ku të rinjtë ishte prezantuar llojlojshmëria biologjike e malit Jablanicë.
2. Një shëtitje në mal ku të rinjtë dëshmuar drejtpërdrejtë pasojat e prerjes së pakontrolluar të malit Jablanicë.
3. Eko-kamp për të rinj që ka zgjatur 3 ditë ku pjesëmarrësit drejtpërdrejtë ishin njoftuar me bimët shëruese, frutat e malit dhe kërpudhat që mund të gjenden në malin Jablanicë dhe mënyrat e përdorimit të qëndrueshëm të tyre.
4. Eko-marshi “Të ruajmë pyjet e malit Jablanicë” me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit Jetësor. Për shkak të prerjes së pakontrolluar dhe paligjshme që vazhdimisht po merr intensitet, vise të gjera të pyjeve në malin Jablanicë janë shkatërruar. Me këtë marsh aktualizohet iniciativa e Shoqatës Ekologjike Maqedonase për shpalljen e Jablanicës për park nacional dhe mbrojtjen e pasurive të rralla.

Projekti “Të rinjtë në lëvizje” është financuar nga Fondacioni Euronatur Gjermani dhe Mava Zvicër, ndërsa mbështetet nga Shoqata Ekologjike Maqedonase.

Më tepër informacione në zakamen.org.mk и www.facebook.com/ZakamenPED





7

“Cvet” nga Krusheva – promotor aktiv i traditës dhe kulturës krushevare

Organizata e Grave “Cvet” nga Krusheva, një prej anëtarëve të para të Rrjetit për Zhvillim Rural, vite të gjata punon aktiv në ruajtjen dhe promovimin e traditës dhe kulturës në Krushevë.

Në fillim të këtij viti, “Cvet” ka organizuar kremtimin e festës Vasilicë, ndërsa një pjesë të mjeteve të fituara nga shitja e lotarisë dhe biletat hyrëse ishin synuar për qëllime humanitare, gjegjësisht për ndihmë të familjeve sociale. Paketa për vitin e ri ishin dhënë fëmijëve nga familjet e cenuar sociale dhe fëmijët me nevoja të posaçme të qendrës ditore në Krushevë.

Në mars, “Cvet” ka mbajtur kuvendin vjetor në kuadër të së cilës ka pasur edhe një ligjëratë në temën “turizmi ekologjik”.

Me anë të mekanizmit projektues të RZR, ishte mbështetur iniciativa e projektit “Edukim për industri kreative”, të cilin Cvet ka zbatuar në bashkëpunim me organizatën “Preda Plus” nga Prilepi. Gjatë muajit prill dhe maj kanë organizuar punëtori edukative për përpunimin me dorë të veshjeve tradicionale me dizajnë të vjetra dhe të reja. Në këtë mënyrë “Cvet” ka kontribuar për transferimin e njohurisë dhe shkathtësive në gjeneratat më të reja dhe përforcim ekonomik të gruas krushevare.

Më 23 maj, gratë nga organizata “Cvet” kanë marrë pjesë në përgatitjen e Odës Vllahe, projekt i realizuar në partneritet me Vetëqeverisjen Lokale, ku janë përgatitur ëmbëlsira të vjetra tradicionale, lloje të ndryshme të likereve dhe ëmbëlsira tjera nga frute.





8

Shënohet dita e parë e pranverës në Pehçevë



Nxënësit e shkollës fillore “Vanço Kitanov” nga Pehçeva, me anë të këngëve dhe valleve ka shënuar ditën e parë të pranverës.

Ngjarja u zhvilluar më 21 mars, ishte mbështetur nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë dhe disa organizata joqeveritare të rajonit të Pehçevës, si dhe shoqatës ekologjike “Solza” dhe Qendra për Bimë Shëruese dhe Fruta Mali “Ambrozija”.

Përveç aksionit të punës për pastrimin e oborrit të shkollës, fëmijët kanë pasur mundësi të njoftohen edhe me ndikimet negative të ndryshimeve klimatike që kanë mbi njerëzit dhe bujqësinë. Gjatë kohës së ngjarjes, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ju ka shpërndarë fanella promovimi me parullë të inspiruar nga ndryshimet klimatike.





9

Fëmijë kultivojnë shalqi dhe fasule në manastirin “Virgjëresha e Shenjtë” në Matkë



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM-së), në bashkëpunim me kompaninë “Maganmak” dhe manastirin “Virgjëresha e Shenjtë” në Matkë, ju kanë mundësuar fëmijëve të vegjël në moshë 6 deri 13 vjeç, nga komuniteti kishtar Krivi Doll, të njoftohen me procesin e mbjelljes, kultivimit dhe rritjes së kulturave kopshtare.

“Aktivitetin e filluam pak para një muaji. U mbledhën rreth njëzet fëmijë, të cilët bashkë me prindërit e tyre i dërguam në kopshtin e manastirit të grave “Virgjëresha e Shenjtë”. Qëllimi ishte të ndikohet mbi edukimit e tyre, por edhe vetë fëmijët të kyçen në aktivitete të caktuara. Ata mbollën fara të vogla të shalqirit dhe fasules në saksit të vogla në të cilët përgatitet fidanët. Farën e ka siguruar Ivan nga Maganma. Secili fëmijë ka marrë me vete në shtëpi dy saksit, një me farë fasule dhe tjetër me shalqi për të monitoruar si ara rriten, vetë të ujin dhe kultivojnë – ka sqaruar Petar Georgievski, kryetar i RZR, që kishte idenë për këtë iniciativë.

Kur bimët u rritën në një madhësi të caktuar, fëmijët sërish shkuan në manastirin më 10 maj dhe mbollën në kopshtin e motrave. Përveç fidanëve të shalqirit dhe fasules kanë mbjellë edhe lule të ndryshme që kanë kontribuar për rregullimin hortikulturor të kopshtit. Kjo ishte edhe një mundësi që fëmijët të njoftohen me njëri tjetrin dhe krijojnë miqësi.

Iniciatorët kanë në plan të zgjerojnë projektin, duke siguruar mjete me anë të fondeve të ndryshme, që të mundë zbatohet në një fermë, në afërsi të Shkupit.

“Kemi fermerë që janë të interesuar dhe dëshirojnë të mbështesin idenë. Përfitimi nuk do të jetë vetëm për fëmijët, por edhe për fermerët. Fëmijët do të mësojnë bazat e kopshtarisë, ndërsa femëri mund të ofrojë fermën e tij për shërbime tjera. Fëmijët do të angazhohen, do të kenë detyrën e tyre dhe do të shkonin atje çdo dy javë, varësisht nga ajo që do të mbillet. Meqë në fermat ka më tepër hapësirë, do të mund të angazhohen më tepër fëmijë. Nga ana tjetër, fermat kanë edhe kafshë, andaj do të njoftohen edhe kafshët. Në Itali, për shembull, ka ferma ku drejtpërdrejtë prodhohet mocarella, andaj secili mund të shikojë si bëhet ajo. Pastaj, për shembull, nga produktet kopshtare fëmijët mund të përgatitin ushqime dhe në atë mënyrë tek ata do të zhvillohet vetëdije për ushqim të shëndetshëm dhe mënyrën e përgatitjes. Ka më tepër ide që mund të zhvillohen, nga të cilët do të kenë dobi edhe fermerët, si për shembull, turizëm bujqësor”, - tha Petar Georgievski.

Murgeshat e manastirit “Virgjëresha e Shenjtë” me kënaqësi ka mbështetur idenë sepse konsiderojnë që ajo është edukative dhe e shëndetshme për fëmijët dhe do të mundësojë të njoftohen më tepër me bimët dhe natyrën.





10

Kuvendi vjetor i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë

Më 5 dhe 6 mars, në hotelin "Hiliday Inn" në Shkup, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka zhvilluar Kuvendin Vjetor të rendit. Gjithsej 37 përfaqësues të 30 organizatave-anëtare të RZR kanë marrë pjesë në takimin dyditor të Kuvendit.

Në sajë të ditës së parë, kompania konsulentë DETRA si zbatues i Programit të USAID për Përmirësimin e Punës së Organizatave – PPPO, ka bërë vlerësimin e ndikimit të saj mbi punën dhe procedurat e punës së RZR dhe organizatave-anëtare. Pas përfundimit të diskutimit dhe vlerësimit të ndikimit të aktiviteteve programore, ishte zbatuar analiza e zbatimit të aktiviteteve në kuptim të: procesit, përfshirjes së anëtarëve të RZR në aktivitetet projektuese, leksione të mësuara dhe mangësi dhe grykë të ngushta.

Dita e dytë e Kuvendit ishte hapur nga kryetari i RZR me një fjalim të shkurtër për anëtarët dhe prezantim të agjendës ditore. Kryetari i Këshillit Drejtues prezantoi aktivitetet e Rrjetit të zbatuar gjatë vitit 2014, si dhe aktivitetet e ardhshme të planifikuara. Nga ana e anëtarëve, me votë njëzëri ishte miratuar programi vjetor i RZR dhe rregulloret për punë të Kuvendit dhe Këshillit Drejtues. Rankica Bozhinovska, nga shoqata "Moja Farma", si anëtare e organit administrativ, ka prezantuar mekanizmin projektues të Rrjetit, duke sqaruar kriteret për mbështetje të projekteve, si dhe për mënyrën dhe procedurën e marrjes së mbështetjes për projekte nga RZR.



Gjysma e dytë e takimit ishte dedikuar punës në grupe për të identifikuar problemet në mjediset rurale dhe sintetizimi i ideve në kuadër të 6 temave të caktuara: *ekonomitë e vogla familjare bujqësore në procesin e tyre për siguri dhe sigurim të ushqimit; rrjetëzimi dhe shërbimet këshillimore nga nevoja e bashkësisë; diversifikimi i aktiviteteve rurale ekonomike (artizanat dhe mbështetja e zhvillimit të turizmit rural); zhvillimi i qëndrueshëm demografik në mjediset rurale (kohezioni social); punësimi i popullatës së re dhe grupe tjera të cënueshme në mjediset rurale; dhe përdorimi i fondeve qeveritare për përdoruesit e në bujqësi dhe zhvillimin rural.* Qëllimi përfundimtar i kësaj punëtorie ishte të ngritët zëri i popullatës rurale, me anë të ideve nga niveli lokal dhe sintetizimi në nivelin kombëtar, për trajtim të mëtutjeshëm në nivelin evropian.



Rrjeti për Zhvillim Rural, pjesëmarrës në Programin e USAID për Përmirësimin e Punës së Organizatave (PPPO)

Rrjeti për Zhvillim Rural (RZR) është një prej organizatave partnere në Programin e USAID për Përmirësimin e Punës së Organizatave nga DETRA Qendra. Qëllimi kryesor i Programit është përmirësimi i veprimtarisë së atyre që konsiderohen si kryesore për zhvillimin e shtetit dhe qëllimet që USAID Maqedoni synon të realizojë. Si pjesë e Programit, RZR merr mbështetje eksperte për përf forcimin e strukturës, përmirësimin e proceseve të punës si dhe përf forcimin e kapaciteteve të të punësuarve dhe të përfaqësuesve të organizatave anëtare të Rrjetit.

Sipas vlerësimit të zbatuar nga PPPO dhe nevojat e zbuluara, fokusi i intervenimeve gjatë periudhës qershor-dhjetor 2014 ishte ndarë në dy fusha: kapaciteti për planifikim strategjik dhe operativ dhe menaxhim me projekte.

Në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara kanë marrë pjesë përfaqësues të zyrës qendrore si dhe përfaqësues të organizatave anëtare të Rrjetit. Mbështetja nga PPPO ishte realizuar me anë të zbatimit të takimeve të mentorëve si dhe një sërë aktiviteteve me ekspertë të fushave të caktuara. Në segmentin që përfshin kapacitetin e rrjetit dhe anëtarët për planifikim strategjik dhe operativ, RZR ka zbatuar një proces të revizionit të planit aktual strategjik. Në këtë drejtim, ishin realizuar katër punëtori në të cilat ishte zbatuar analiza e kapaciteteve të brendshme organizative dhe kontekstin e punës së Rrjetit, pas të cilës ishin reviduar vizioni dhe misioni i Rrjetit ndërsa



ishte përcaktuar edhe fokusi strategjik për tre vitet e ardhshme. Ky proces ka mundësuar një përfshirje më të madhe të anëtarëve të Rrjetit në mënyra të ndryshme me çfarë kontribuoi në përf forcimin e komunikimit dhe thellimit të përkatësisë dhe unitetit në Rrjetin. Plani strategjik i RZR-së ishte finalizuar në shtator të vitit 2014 me çfarë Rrjeti bashkë me PPPO ka mbajtur dy promovime në zyrat rajonale në Pehçevë dhe Gostivar.

Hartimi i Programit Vjetor të Rrjetit ishte zbatuar me një sërë punëtorish dhe mbështetje mentorimi gjatë muajit nëntor dhe dhjetor. Ishin zhvilluar punëtori për planifikim të integruar të Rrjetit në të cilën kanë marrë pjesë

përfaqësues të organizatave anëtare që janë njoftuar me rëndësinë e procesit për planifikim të integruar vjetor, kontributin që pritet nga ata në procesin e planifikimit të integruar, natyra dhe spektri i procesit të plotë për planifikim vjetor si dhe elementet dhe dimensionet kryesore. Si rezultat i punëtorisë, pjesëmarrësit kanë caktuar aktivitete prioritet për RZR në vitin 2015 dhe kanë zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta të anëtarëve dhe RZR. Pastaj, një grup më i vogël i punës vazhdoi të punojë në zhvillimin e Programit Vjetor si dokument konkret që duhet të miratohet në seancën e Kuvendit të RZR të planifikuar për në mars të vitit 2015.



Për të themeluar një grup të brendshëm të trajnerëve potencial dhe facilitator të trajnuar që do të mund pavarësisht të menaxhojnë dhe lehtësojnë aktivitetet e Rrjetit në fushën e ngritjes së kapaciteteve, PPPO ka realizuar një trajnim për integrator të brendshëm. Në këtë trajnim, një grup prej 12 përfaqësues të organizatave anëtare kanë përmirësuar shkathhtësitë e tyre të facilitimit dhe ishin njoftuar me qasjen e punës që DETRA Qendra e përdor në sajë të SKIPTOP metodologjisë së saj. Më tutje, një grup më i vogël i këtyre pjesëmarrësve kanë marrë pjesë në trajnim për trajnerë për përgatitjen dhe zhvillimin e planeve strategjike dhe vjetore. Ky grup i trajnerëve, me mbështetje mentori të PPPO¹ ka zbatuar procesin e zhvillimit të 5 planeve strategjike dhe 5 vjetore të anëtarëve të Rrjetit. Versionet finale të planeve strategjike dhe vjetore priten në mars të vitit 2015.

Fokusi i dytë i mbështetjes së PPPO për Rrjetin ka të bëjë me përforcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve për punë projekt. Për këtë qëllim gjatë tetorit dhe

nëntorit ishte organizuar një punëtori për udhëheqje me ciklin projektues të përbërë nga dy module në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave anëtare bashkë me pjesëmarrës dhe organizata tjera partnere të PPPO. Pjesëmarrësit kanë punuar në zhvillimin e ideve të tyre të projektit duke përdorur metodologjinë Korniza Logjike dhe kanë pasur mundësinë të përfitohen me njohuri për logjikë të intervenimit, rezultate të projektit, indikatorë dhe buxhet. Si rezultat i kësaj punëtorie, dy organizata anëtare të Rrjetit – “Moja Farma” dhe “Kozjaçija vo srceto” kanë zhvilluar një iniciativë të përbashkët të projektit që rezultoi me aplikim në thirrjen e Programit të Ambasadës së Amerikës për grante të vogla. Iniciativa ishte identifikuar me anë të kontaktit të drejtpërdrejtë me gratë nga rajonet rurale në Kumanovë dhe Gostivar dhe kanë për qëllim të rrisin vetëdijen për rëndësinë e emancipimit të grave në rajone rurale.

Më tutje, Rrjeti me mbështetjen e PPPO ka realizuar dy punëtori për zhvillimin e modelit për menaxhim të projektit.

Në këtë proces ishin përfshirë anëtarë të strukturës menaxhuese bashkë me disa përfaqësues të anëtarëve të Rrjetit. Grupi i punës ka zhvilluar kornizë për mekanizëm të qëndrueshëm të projektit brenda Rrjetit me të cilën do të mbështetet përgatitja dhe zbatimi i projekteve të vogla në pajtim me metodologjinë e ciklit projektues. Duke filluar nga dhjetori, Rrjeti ka filluar procesin e pilotimit të këtij modeli. Pasi që ishin zhvilluar gjitha procedurat e nevojshme dhe ishin emëruar organe përgjegjëse, ishte publikuar thirrja për mbështetje të propozimeve të projektit nga anëtarët që ishte plotësuar me ngjarje rajonale informative të udhëhequr nga përfaqësues të Rrjetit. Pas përfundimit të afatit për paraqitje, organi përgjegjës i shqyrtoi aplikacionet dhe zgjodhi tre organizata (Cvet – Krushevë, Organizata e Grave – Pehçevë dhe Slozuvalka – Gjevgjeli) që do të marrin mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve të tyre të projektit. Gjatë kësaj një prej kriterëve kryesore për kualifikim ishte themelimi i partneriteteve mes anëtarëve në zbatimin e ideve të projektit.

Përveç kësaj, deri në qershor 2015, kur edhe duhet të përfundojë mbështetja e PPPO, ishin realizuar aktivitete për përforcimin e kapacitetit të Rrjetit në fushat e etikës së punës, komunikimit të brendshëm dhe mësimi organizativ.





Koncepti i mekanizimit për projekte

Shoqëria civile e Maqedonisë, që pjesa më e madhe e tyre janë themeluar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtar, ende janë të varur nga donatorët në pjesë të madhe. Kjo vlen edhe për organizatat anëtare të RZR-së që në përgjithësi kanë mungesë të kapacitetit për koncepte dhe aftësinë për të zbatuar programet përfituese në komunitetin rural. Nga kjo, RZR ka ofruar një program specifik sipas nevojës për ngritjen e kapacitetit për të siguruar organizatat anëtare me njohuri në nevojshme, shkathtësitë dhe përvojat që si rezultat të arrihet më pak varshmëri nga donatorët.

Me mbështetjen e Programit për Përmirësimin e Performancës së Organizatave të USAID, RZR ka zhvilluar një model për menaxhim me projekte që quhet Mekanizmi për Projekte. Anëtarët e strukturës menaxhuese të RZR dhe përfaqësuesit e organizatave anëtare ishin të përfshirë në procesin e zhvillimit të kësaj vegje. Grupi i punës ka zhvilluar një kornizë për mekanizimin e qëndrueshëm të projekteve brenda Rrjetit, si mbështetje në përgatitjen dhe zbatimin e iniciativave të vogla për projekte sipas metodologjisë së ciklit projektues.

Për procesin e mekanizmit të projekteve, ishin zgjedhur pilotimi i tre propozimeve të projektit (Cvet – Krushevë, organizata e grave – Pehçevë dhe Sillozhuvallka – Gjevgjeli) dhe ishte alokuar mbështetje financiare për zbatimin përkatës. Gjatë tremujorit prill-qershor të gjitha tre projektet e vogla ishin kompletuar me sukses.

Me anë të komponentit për ngritjen e kapaciteteve të projektit të USAID për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, RZR ka siguruar mbështetje për tetë iniciativa tjera për projekte të RZR anëtarëve dhe kanë shpallur thirrjen e dytë të brendshme për mbështetje të aktiviteteve për projekte. Trupi Koordinues ka organizuar takime informimi në 6 vende të ndryshme (Kumanovë, Pehçevë, Gjevgjeli, Gostivar, Manastir dhe Strugë) dhe ka furnizuar RZR anëtarët nga pjesa lindore dhe perëndimore e Maqedonisë me sqarime për kriteret e thirrjes. Pakoja e aplikimit për këtë thirrje mbi propozime ishte ndarë me gjithë organizatat anëtare të RZR me anë të e-mail dhe ueb faqes së RZR-së.

Deri në afatin e fundit për dorëzimin e propozimeve për projekte (30 prill), RZR ka pranuar 11 aplikacione, secila e përgatitur në partneritet me së paku dy organizata anëtare të RZR. Trupi Koordinues i përbërë nga përfaqësues të RZR organizatave, kanë zhvilluar dy takime në maj dhe kanë bërë vlerësimin e gjithë aplikacioneve në dy nivele: kompetenca teknike (dorëzimi i gjithë dokumenteve të nevojshme) dhe përmbajtja. Tetë projekte ishin zgjedhur pas vlerësimit: pesë ishin në përputhje të plotë me kriteret e mekanizimit për projekte, ndërsa nga tre prej aplikuesve ishte kërkuar të bëhen modifikime. RZR-ja ka nënshkruar Memorandum

Mirëkuptimi me organizatat fituese që në qershor kanë filluar me zbatimin e iniciativave të projekteve më poshtë:

1. “Promovimi i kapaciteteve lokale me katalog të produkteve ushqimore të konservuar”

Bartës i aplikacionit: Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike
Partner: Shoqata për edukim të fëmijëve dhe të rinjve “Sillozhuvallka”

2. “Promovimi i Grykës së Bislimit “Ejani!Shikoni!Kënaquni! Dhe tregoni për bukuritë e Grykës së Bislimit”

Bartës i aplikacionit: Shoqata e qytetarëve të Grupit Lokal të Aksionit për Zhvillim Rural “ZËRI I FSHATIT”
Partner: Qendra për Zhvillim Rural “BUJRRUM”

3. “Turizmi rural si mundësi për zhvillim të komunitetit dhe bashkëpunim”

Bartës i aplikacionit: Shoqata Qendra për Bimë Shëruese dhe Fruta Mali “AMBROZIJA”
Partner: Shoqata ekologjike “Sollza”

4. “LIDER FEST 2015”

Bartës i aplikacionit: Qendra Rajonale për Përfaqësim Delçevë
Partner: Shoqata Qendra për Bimë Shëruese dhe Fruta Mali “AMBROZIJA”

5. “Promovimi i potencialeve për zhvillim të turizmit rural – STRUGA RURALE”

Bartës i aplikacionit: Shoqata Qendra Kreative “RURBANKULT”
Partner: Shoqata për Mundësi të Barabarta EZERKA

6. “Promovimi i Malesh nëpërmjet traditës kulturore”

Bartës i aplikacionit: Shoqata e hotelierëve, punonjësve turistik dhe artizanëve “Napredok”
Partner: Qendra për Kulturë dhe Informacione “RAVEN”

7. “ORGANIKA”

Bartës i aplikacionit: Instituti për Zhvillim të Komunitetit
Partner: Shoqata e Fermerëve Gra “MOJA FARMA”

8. “Turizmi rural zhvillim i qëndrueshëm”

Bartës i aplikacionit: Shoqata e Prodhuesve të Llojeve Kopshtare dhe Luleve HORTI EKO
Partner: Shoqata e Fermerëve Gra “AGRO-VINKA”



13

Afirmim të LEADER qasjes në Rajonin Juglindor dhe Lindor të Planifikimit

Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së (RZR – RM), si organizatë që fokusohet në zhvillimin e organizatave rurale, vazhdon me mbështetjen e aktiviteteve për promovim të LEADER qasjes, që nxit përfshirje të madhe të popullatës rurale në procesin e vendimmarrjes për çështje të rëndësishëm të komunitetit. Si pasojë, me anë të projektit të USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, RZR i RM ka zbatuar aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të LEADER, për aktorët e 4 komunave në rajonin juglindor të planifikimit: Strumicë, Vasielë, Bosillovë dhe Novo Sellë. RZR-ja ka mbështetur krijimin e një entiteti, Grupin Lokal të Aksionit në formë të partneritetit privat-publik duke përfshirë partnerë nga sektori publik, privat dhe qytetar, dhe duke mbuluar interesat e palëve të ndryshme të interesit nga këto komuna. Grupi ka zhvilluar një dokument strategjik për zhvillim lokal në bazë të së cilës ishin përgatitur dhe zgjedhur 3 projekt iniciativa që do të zbatohen gjatë periudhës vijuese.

Në kohën e njëjtë, RZR i RM-së ka zgjedhur këto aktivitete edhe në Rajonin Lindor të Planifikimit duke zhvilluar takim fillestar për promovimin e LEADER qasjes, më 11 shkurt 2015, në Berovë. Gjatë muajve të fundit, RZR ka organizuar më tepër punëtori në komunat: Pehçevë, Berovë, Dellçevë dhe Makedonska Kamenicë, gjatë së cilës palët e interesuara të rajonit kanë pasur mundësinë të njoftohen me parimet e LEADER qasjes dhe të përfitojnë shkathtësi për hartimin e strategjisë për zhvillim lokal.





Prezantim të zbulimeve të Studimit për Adaptimin e Prodhimtarisë Bagëtoresh në Republikën e Maqedonisë ndaj ndryshimeve klimatike në Manastir

Më 24 mars, në Manastir, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka zhvilluar edhe një punëtori për prezantim të zbulimeve nga Studimi për Adaptim të Prodhimtarisë Bagëtoresh në Republikën e Maqedonisë ndaj ndryshimeve klimatike, që ishte hartuar në sajë të projektit të USAID-it për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike.

Prof. Dr. Sreten Andonov, si koordinatori i ekipit të ekspertëve që ka përgatitur studimin, ka sqaruar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike mbi sektorin bagëtor, dhe ka dhënë drejtime dhe këshilla për zbatim të masave përkatëse adaptive dhe përgatitje me kohë të prodhimtarisë bagëtoresh për këto ndikime negative të pritura.



Zhvillohet seanca e shtatë kuvendare e RBZR

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikë së Maqedonisë ka marrë pjesë në seancën e shtatë kuvendare të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RBZR) që u zhvillua më 27 prill 2015 në Bruksel. Në takimin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e PREPARE – Partneriteti për Evropë Rurale, Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi, Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural dhe Komisionit Evropian. Kuvendi ishte mbështetur nga Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SWG).





Parlamenti i Dytë Rural në Letoni dhe takimi i PREPARE Partneritetit për Evropë Rurale

Në periudhën nga 3 deri 5 qershor 2015, në qytetin e vogël Ligatne, në Letoni, u mbajt parlamenti i dytë i komuniteteve rurale letoniane "Krijimi i parakushteve për zhvillim të qyteteve të vogla dhe mjedisve rurale". Ngjarja treditëshe e organizuar nga Forumi Rural i Letonisë dhe Fondacionit për Integrim Shoqëror, ka mbledhur rreth 250 përfaqësues të aktorëve të ndryshëm nga mjediset rurale të Letonisë dhe Evropën më gjerë, mes të cilëve ishte edhe përfaqësuesi i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë në shumë tema relevante për komunitetet rurale dhe të shkëmbejnë përvoja dhe praktika të mira.

Ligatne është një qytet i vogël në largësi prej 72 km nga kryeqyteti Riga. Shpesh quhet edhe "qyteti i shpellave" për shkak të 333 shpellave në rrethinë. Ajo është vendi i fabrikës më të vjetër për letër në Letoni, e themeluar në vitin 1815. Pjesëmarrësit e parlamentit kanë vizituar iniciativa praktike në afërsi të Ligatne, që kanë prezantuar ide inspirimi për zhvillimin e komuniteteve rurale.

Qëllimi kryesor i parlamentit të dytë letonian ishte zhvillimi i Rezolucionit të përbashkët me të cilën komunitetet dhe krijuesit e politikave do të marrin përsipër të zhvillojnë aksione specifike



gjatë 2 viteve në vijim, si dhe disa aksione më afatgjate.

PREPARE partneriteti për Evropë Rurale ka shfrytëzuar këtë mundësi të mbledh partnerët e saj më 5 dhe 6 qershor në Riga ku ka zhvilluar një mbledhje koordinimi. Përveç temave aktuale, në mbledhjen ishte diskutuar për Parlamentin Evropian Rural, të dytin me rend, ku RZR i RM do të ketë rol aktiv në procesin e mbledhjes dhe sintetizimit të problemeve dhe ideve që dalin nga popullata rurale në Maqedoni dhe adresimi i tyre në nivel kombëtar dhe atë të BE-së.

